



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 208/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të vendosjes se posterit në objektet publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Prizren, me të cilën pretendohet se më 08.10.2013 në objektin e bashkësisë Lokale 10 Qeshor në rrugën " Ismet Jashari Kumanova" anëtarë të Partisë Demokratike të Kosovës , kanë vendosur posterë të kandidatit për kryetar Komune ky subjekt Ramadan Muja në ndërtesën e objektit të lartëpërmendur. Sipas parashtrusit të ankesës është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) të LZP, neni 3 pika b) e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore Nr. 01/2013. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 09.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.10.2013, në ora 12:00.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK sipas afatit të caktuar, ku konsideron se janë të pa baza pretendimet e Lëvizjes Vetëvendosje, lidhur me shkeljen e Rregullave të përcaktuara në nenin 33 pika b) të LZP ose nenit 3 pika b) e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike. Po ashtu në përgjigjen në ankesë theksohet se nga fotografit e ofruara në ankesë për asnjë moment nuk identifikohet objekti për të cilin pretendohet se është objekti i Bashkësisë Lokale 10 Qeshori në rrugën " Ismet Jashari - Kumanova " në Prizren.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se poster i kandidatit për kryetar komune Ramadan Muja nga subjekti politik PDK, është i vendosur në ndërtesën e objektit të Bashkësisë Lokale 10 Qershori, nuk qendërojnë ngase nga fotografia e bashkangjitur si provë nga parashtruesi i ankesës, nuk mund të identifikohet objekti për të cilin pretendon pala ankuese. Andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 208/2013 më datën 17.10.2013

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*